



SHOQATA KOMBËTARE E GRUAS PROFESIONISTE, AFARISTE DHE ZEJTARE

DITA E EUROPËS

Editorial

Më 9 maj 2018, në kuadër të Ditës së Europës 2018, Ambasadorja e BE-së në Shqipëri, znj. Romana Vlahutin organizoi një pritje kushtuar Grave në Shqipëri.

Në këtë pritje, nga Shoqata Kombëtare e Gruas Profesioniste, Afariste dhe Zejtare (SHGPAZ), mori pjesë presidentja znj. Flutura Xhabija.

Ky aktivitet organizohet pas njoftimit gjatë muajit prill 2018 që Shqipëria morri përgjigjen pozitive për propozimin që Komisioni European i paraqiti Këshillit të Europës për hapjen e negociimeve për hyrjen në BE të Shqipërisë.

Ky është një lajm i mirë për të gjithë shqiptarët, që aq shumë e kanë dëshiruar Shqipërinë si pjesë të BE-së. Shpresojmë që ky propozim të miratohet në mbledhjen e qershorit.

Hapja e negociatave të Shqipërisë me BE-në është një hap mjaft i rëndësishëm dhe i nevojshëm për të bërë të mundur që qeveria shqiptare të mos shkeli më standartet e BE-së në të gjitha fushat.

Shoqëria civile do të lozi një rol të veçantë në këto negociime.

Suksese!



Buletin Informativ

Maj 2018

NË KËTË NUMËR

Konferenca Ballkanike: kontributi i sipërmarrjes femërore, Prishtinë

Më 4 maj 2018, u mbajt në Prishtinë takimi b2b me sipërmarrëset femërore të rajonit Shqipëri, Kosovë, Mal i Zi dhe Serbi.

Faqe 2



OSHC të afta për t'u adaptuar në kohë ndryshimesh

Më datë 4 maj 2018, u mbajt në Tiranë takimi për prezantimin e modeleve të reja biznesi për ekzistencën dhe forcimin e organizatave të shoqërisë civile.

Faqe 10



Konferenca Ballkanike kontributi i sipërmarrjes femërore

Më 4 maj 2018, u mbajt në Prishtinë takimi b2b me sipërmarrëset femërore të rajonit Shqipëri, Kosovë, Mal i Zi dhe Serbi. SHGPAZ u përfaqësua me pesë anëtare.

Takimi njëditor ishte i thjeshtë, por mjaft aktiv dhe interchange; b2b-te pas fjalimeve premtuese e falenderimeve ishin të dobishme dhe jo vetëm miqësore; tavolina e SHGPAZ, numri 4 u vizitua nga dhjetra kolege sipërmarrëse (pa perjashtim të gjitha shqiptaret nga Kosova, por të ftuara ishin edhe nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia) të njohura më parë, por edhe sipërmarrëse të reja (në dominancë) që shpejtonin të afronin shërbimet dhe produktet e veta.



Konkursi IDEA për plane biznesi



Në kuadër të Konkursit **IDEA** për plane biznesi, gjatë

muajit maj janë organizuar 2 start-ups weekend, me trainime me aplikantët e përzgjedhur në qytete të ndryshme si Vlorë, Korçë dhe Tiranë, si dhe ka filluar faza II.

Ky projekt mbështet të rinjtë që kanë një ide biznesi ose drejtojnë një biznes prej më pak se 3 vjet.

Konkursi IDEA ofron një paketë të plotë mbështetjeje nëpërmjet seancave tërheqëse të trajnimit, coaching/këshillim, mentorim dhe fituesve do t'u ofrohet grant.

Linku i IDEA në facebook:

www.facebook.com/ideaalbania

Bankat dhe biznesi


Ndikimi i kursit të këmbimit për SME-të

Në muajt e fundit dëgjohet shpesh të flitet për ecurinë e kursit të këmbimit të lekut ndaj monedhave kryesore, në veçanti ndaj euros. Në këto diskutime argumentohet si për ndikimin pozitiv ashtu edhe negativ që ky

mbiçmim ka për aktivitetin ekonomik në vend. Deri në maj 1 euro kushton 127 lekë ose 5% më pak se në fund të vitit

2017. Krahësuar me një vit më parë mbiçmimi i lekut është akoma më i madh, prej 8%, duke prekur mbiçmimin më të lartë historik. Ky mbiçmim ka ardhur si rezultat i ofertës të shtuar së eurove, e cila reflekton përmirësimin e faktorëve fundamental të tillë si rritje e aktivitetit ekonomike në vend, ulja e primeve të rrezikut dhe preferencën e agjentëve ekonomik për mbajtjen e kursimeve të tyre. Gjithsesi, mbiçmimi i lekut ndaj monedhave të huaja është një fenomen që në tre vitet e fundit ka prekur pothuajse të gjitha vendet e rajonit të ngjashme me Shqipërinë, e ndikuar më së shumti nga faktorë fundamental. Kështu përmirësimi i vazhdueshëm i llogarisë korrente, flukset në rritje të investimeve të

huaja dhe lëvizjet të kapitalit drejt këtyre vendeve, janë ndër arsyt kryesore që mbështetin këtë mbiçmim strukturor të monedhave të vendeve të Evropës Qendrore dhe



Juglindore.

Natyrshëm lind pyetja si e ndikon mbiçmimi i lekut ndaj euros veprimtarinë e biznesit të vogël dhe të mesëm (SME)? Duke parë shifrat e ndjeshme të mbiçmimit si dhe ekspozimet e mëdha të SME-ve ndaj luhatjeve të kursit, e kupton që ky ndikim është i rëndësishëm dhe i prekshëm për të gjithë bizneset.

Kanalet kryesor që ky mbiçmim ndikon në aktivitetin e SME-ve mund të përmbledhen në katër kanale kryesore, të tilla si kanali tregtar; ai financiar; sektorin e shërbimeve si dhe në perceptimin e pasigurisë për zhvillimet në të ardhmen. Ndikimi i secilit prej tyre varion ndjeshëm i kushtëzuar nga profili i biznesit SME, nga sektori ku ai vepron; përdorimit të levës financiare- ekspozimit që ka biznesi ndaj bankave si dhe

qeverisjes së vet biznesit, nëse ai ka krijuar një mbrojtje natyrale apo jo.

Ndikimi i kursit në kanalin tregtar është i ndjeshëm si në drejtim të eksporteve ashtu edhe të importeve. Në vitin 2017 eksportet shqiptare përbëjnë 32% të PBB-së, raport i cili ka ardhur në rritje në vitet e fundit, përkundrajt 26% që zinte në vitin

2009. Në aspektin teorik një mbiçmim i kursit të lekut ndaj monedhave të huaja ndikon në shtrenjtimin e eksporteve tona.

Ky shtrenjtim do të ndikonte në uljen e konkurrueshmërisë së bizneseve në

tregjet e huaja si dhe ndoshta në rënien e kërkesës për këto produkte. Për më tepër ndikimi është akoma më i madh nëse mendojmë që shumë prej kontratave të eksportuesve nënshkruhen një vit më parë dhe përgjithësisht ato faktorizojnë kursin e këmbimit të lekut ndaj euros të asaj periudhe.

Si të tilla këto çmime të nënshkruara që përbejnë dhe të ardhurat e tyre për gjithë vitin aktual do të ngushtonin ndjeshëm marxhin e fitimit. Gjithsesi, kjo humbje nga çmimet e kontraktuara materializohet në ato biznese eksportuese të cilat shpenzimet i kanë lekë, por të ardhurat i kanë në valutë dhe paralelisht nuk kanë ndërmarrë asnjë mbrojtje natyrale për të mbuluar këtë kosto shtesë.

Krijohet Sekretariati Teknik i Këshillit Ekonomik Kombëtar

Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin për krijimin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar. Sekretariati do të jetë institucion buxhetor publik në varësi të ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, me seli në mjediset e Kryeministrit.

Referuar vendimit, Sekretariati Teknik ka si qëllim t'u mundësojë bizneseve të adresojnë shqetësimet e tyre dhe të gjejnë përkrahje në mënyrë që propozimet e tyre t'u përcillen institucioneve politikëbërëse dhe vendimmarrëse, për reduktimin e

pengesave administrative me të cilat ndeshet biznesi në veprimtarinë e përditshme, të evidentuara si problematike,



nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike ndaj sipërmarrjes dhe klimës së biznesit në Shqipëri.

Sekretariati teknik do të financohet nga buxheti i shtetit dhe nga çdo burim tjetër financiar i ligjshëm ndërsa për periudhën deri në miratimin e fondeve përkatëse të buxhetit të shtetit për plotësimin me personel organik, detyrat e sekretariatit teknik do të përmbushen nga punonjës të komanduar ose të punësuar me kontratë të përkohshme.

Të shpresojmë që funksionimi i sekretariatit do të fillojë sa më parë dhe me efektivitet në mbështetje të bizneseve!
(Burimi: scan TV)

Forumi “Skills for Future 2018” Java e Aftësive Shqiptare 2018



Tirana Business Park, 7 Maj 2018
Communication Progress, 7 Maj 2018
ABiEsse shpk, 8 Maj 2018
Universiteti Politeknik, 9 Maj 2018
AlbeSol shpk, 9 Maj 2018
EuroElektra shpk, 10 Maj 2018
Tirana Business Park, 11 Maj 2018
Tirana Business Park, 12 Maj 2018

ALBANIAN SKILLS WEEK 2018 është event i parë i këtij lloji në Shqipëri.

Nëpërmjet kësaj platforme dhe organizimi, Albanian Skills synon të vazhdojë të ofrojë në një dimension më të gjerë angazhimin dhe misionin publik të ndërmarrë prej 4 vitesh në dobi të promovimit të talentëve të rinj profesionistë të fushave të ndryshme dhe kështu rritjen e interesit të tyre për Zhvillimin e Aftësive Profesionale dhe ndaj Arsimit dhe Formimit Profesional si rrugët e vetme për perspektiva të suksesshme punësimi dhe jetese dinjitoze. www.albanianskills.org

Projekti Interreg-IPA CBC

Itali-Shqipëri-Mali i Zi

Më datë 23 maj 2018, në hotel Tirana, Ministria e Financës & Ekonomisë lançoi projektin rajonal "P.A.S.T.4 Future" "Nxitja e turizmit të qendrueshëm dhe për njerëzit me paaftësi fizike", ku partner lider është Ministria e Financës & Ekonomisë së Shqipërisë dhe me partner të tjerë Bashkinë e Malësisë së Madhe, si dhe dy partner nga Italia dhe dy partner të tjerë nga Mali i Zi.

Në këtë takim merrnin pjesë ministri i Financës & Ekonomisë z.Arben Ahmetaj, zv/ministri i Turizmit dhe Mjedisit, si dhe zv/ministrja e Shëndetësisë & Mbrojtjes Sociale.

Nga përfaqësues të partnerëve u bë prezantimi i projektit me kohëzgjatje 2 vjet dhe që do të pilotohet në zonën e Malësisë së Madhe me krijimin e infrastrukturës së përshtatshme edhe për personat me aftësi të kufizuara fizike; për krijimin e web platform si dhe menaxhimin e turizmit ndërkufitar.



Paketa fiskale 2019

Diskutim me biznesin



Më datë 28 maj 2018, me iniciativë të Unionit të Dhomave të Tregtisë & Industrisë, u mbajt tryeza me shoqatat e biznesit për diskutimin e pakës fiskale të vitit 2019. Ministri i Financave & Ekonomisë prezantoi ndryshimet në paketën fiskale të vitit 2019, e cila konsiston në:

- Uljen e barrës fiskale për bizneset me xhiro vjetore nga 8-14 milion leke ulja e tatim fitimit nga 15% në 5%.
- Sektori i energjive të rinovueshme diellore heqja e TVSH për linjat teknologjike
- Ndryshimi i tatimit mbi të ardhurat për bizneset e agroturizmit në 5%. Normë e reduktuar e TVSH për shërbimet e akomodimit dhe ushqimit (përfshirë pijet) në 6% . Heqja e taksës së infrastrukturës në bizneset e agroturizmit.

Nga shoqatat e biznesit u vlerësua ky reduktim i barrës fiskale, por patën edhe shumë vërejtje të tjera që shprejnë të merren parasysh: si më shumë kujdes për reduktimin e barrës fiskale për ekonominë kreative dhe profesionistëve.

Bashkëpunim SHGPAZ me Akademinë e Biznesit Profesional

Kolegji Universitar i Biznesit/ Akademia e Biznesit Profesional: një vatër e vërtetë mësimore, akademike, praktike dhe shembull special i biznesit familjar, high class! SHGPAZ ka



një partneritet real me këtë institucion universitar që është certifikuar nga realiteti, biznesi, dobia e një diplome të vlefshme për të gjitha palët zhvillimore!

Më datë 25 maj 2018 në konferencën shkencore ishte e ftuar për të pershëndetur presidentja e SHGPAZ, znj.Flutura Xhabija.

Gëzuar Ditën e nënës



Dogana - përjashtime nga TVSH për biznesin e vogël

nga **Violeta Shqalsi**

Në një kohë kur, në kuadër të reduktimit të informalitetit, qeveria ka vendosur TVSH për bizneset me xhiro vjetore mbi 2 milion lekë/vit, gjithashtu ajo ka marrë disa masa lehtësuese për këtë kategori. Kështu biznesi i vogël përjashtohet nga TVSH e makinerive nëse ata importojnë për qëllime investimi. Në këto raste biznesi i vogël, i cili do të importojë makineri prodhuese dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit të tyre, për të përfituar duhet të paraqesë në Degën Doganore përkatëse dokumentet e mëposhtme:

- një kërkesë me shkrim pranë autoriteteve doganore, kur kryhen veprime për herë të parë, së cilës, i bashkëngjitet edhe një fotokopje e certifikatës së NUIS/NIPT-it;



- vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore se importuesi është person i tatueshëm që i nënshtrohet regjimit të biznesit (ndërmarrjeve) të vogla dhe ushtron aktivitet prodhues;
- kopje të ekstraktit të QKR-së;
- të dhëna për llojin dhe sasinë e makinerive prodhuese që do të importohen me kodet tarifore përkatëse dhe për periudhën e instalimit.

- Deklaratë e personit të tatueshëm që makineria apo pajisja, për të cilën kërkohet

përjashtimi, nuk është importuar për qëllime shitjeje.

Gjithashtu përjashtime të tjera tjera nga taksat doganore janë miratuar edhe për organizmat ndërkombëtarë, personat fizikë, organizatat bamirëse, filantropike ose fetare, entet publike si dhe entet shtetërore buxhetore.

- Misionet diplomatike dhe konsullore si dhe misionet speciale të kredituara në Shqipëri;
- Invalidët tetraparaplegjikë dhe paraplegjikë përjashtohen për pajisje, karroca, perfshirë autovetura të përshtatura për përdorimin e tyre në pronësi të invalidit tetraplegjik ose paraplegjik, jo më shumë se 2500 kubikë.

- Mallrat që importohen në kuadër ndihmash humanitare si: ushqime, barna, veshje dhe shtresa ose mbulesa krevati, zjarrëfikese dhe ambulanca për qëndra shëndetësore.
- Mallrat e importuara me qëllim të nxitjes së tregtisë si mostrat e mallrave me vlerë të papërfillshme, materialet e shtypura reklamuese, produkte që përdoren apo konsumohen në panairë tregtare apo ngjarje të ngjashme.

Forumi Kombëtar i Biznesit (NBF)



Më datë 24 maj 2018 u mbajt Konferenca Vjetore e Forumit Kombëtar të Biznesit (NBF), në Hotel Tirana. Në këtë konferencë të organizuar nga ACER me drejtor Zef Preçi, merrnin pjesë Ministrija e Sipërmarrjes znj. Sonila Qato, zv/ministri i Financave & Ekonomisë z. Altin Haxhi, si dhe ekspertë të tjerë të tatimeve.

Në këtë konferencë u prezantuan arritjet kryesore dhe sfidat e NBF përgjatë një viti, si dhe rezultatet e raportit të monitorimit në drejtim të Kontrollit Tatimor; Informalitetit; Sektorializimi i TVSH, Dialogu Publik-Privat. Të gjitha raportet e monitorimit ishin të përgatitura mirë dhe mjaft të vlefshme.

Ekspertë të tatimeve iu përgjigjën pyetjeve problematike që has biznesi nga kontrollet e shpeshta tatimore.

Znj. Flutura Xhabija prezantoi raportin e monitorimit për dialogun publik-privat.



FAKTE

26.8%

Biznese aktive të drejtuar/pronare gra, për vitin 2016 në Shqipëri rezultojnë 26.8% me një rënie me 4.5 pikë % në krahasim me vitin 2015 ku përbënin 31.3%. (INSTAT)



Takim Rajonal “gratë munden”

Më 19 maj 2018 u mbajt në Podgoricë takimi rajonal me temë: “gratë munden”, i financuar nga Ministria e Drejtësisë Njerëzore dhe Shoqërore! Pjesëmarrje pak rajonale dhe shumë nacionale, por me fokus gruan në biznes. Kishte tre panele: politikëbërës, përfaqësues bankash, shembuj biznesesh të suksesshme! SHGPAZ kishte pjesëmarrje shumë cilësore dhe u bënë biseda pune mjaft të mira!



3.2%

Kredia për vitin 2017 rezulton me një rritje modeste me vetëm 3.2% krahasuar me një vit më parë dhe zë 36,5% ndaj PPB, me një ulje prej 1 pikë përqindje krahasuar me 2016. (Banka e SHqipërisë)



Delegacioni European takim me shoqërinë civile në Pogradec

Në kuadër të Ditës së Europës, Ambasadorja e Delegacionit European organizoi takim me shoqërinë civile në Pogradec.



Vizitë tek sipërmarrësja Monda Bezatlliu-Koja, në Durrës

Nga Flutura Xhabija

26 maj 2018 Durrës. Një e shtunë ndryshe: tre biznese në një familje, bashkë e veç-e-veç, me përkushtim, pa suporte shtetërore, me rregullsi ligjore, me imagjinatën e tyre, me krahët e vullnetin e tyre, me ndershmërinë e vërtetë të tyre, me zemrën e artë të tyre, me edukatën origjinale të lartë dhenje mrekulli! Quhet **Monda Bezatlliu Koja**-artizane, menaxhere, fotografe, perdoruese e IT (nuk ka diplomë universitare), inovatore, nënë e tre djemve, bashkëshorte e përkushtuar etj, etj; Maksi, burri i saj, çfarë i sheh syri i bën dora; mirëmban gjithë hotelin (as ky jouniversitar), receptionist i mbaruar, profesionist meremetues, riparues, arkitekt dhe zbatues, familjar i rrallë, djemtë me shkollë: një student e tjetri gjimnazist, mjeshtra të vidiove, fotografive dixhitale, punëtorë të mirë dhe bashkëpunues; me një fjalë mjedis perfekt pune, suksesi dhe lumturie!

Prandaj dhe Ne, morëm rrugën të marrim pervojë nga anëtarja jonë e rregullt dhe mjaft miqësore; pasi u bashkuam, vizitën e filluam tek atelje Monda, fotot e tregojnë; pas kafes së parë vizituam hotelin "Maksi" dhe dhomat e tij dhe iu kthyem tryezës së drekës për të bërë konkluzionin e bzb -se praktike: puna lindi e para, pastaj fjala! Vizitoni këtë familje biznesore në Durrës, plazh, zona e Ilirisë! E sigurtë që do të kënaqeni! Të tillë




ka mjaft, por reklamim nuk i bëhet, sepse nuk "kanë kohë" zyrtarët!

Bravo Monda&Maksi, mundi nuk ju ka shkuar dëm dhe jeni shembull!



NDERIM për Flutura Xhabija



Takim me Drejtoren e Doganave


Më datë 28 maj 2018 në ambjentete e DHTI Tiranë u organizua një takim biznesi me drejtoren e doganave znj. Belinda Ekonomi, ku prezantoi nismat në dobi të biznesit: tashmë importuesit do t'i bëjnë veprimet për çdoganimin e mallrave on line dhe eksportuesit do të fillojnë nga shtatori.



Do të krijohet data base për personat e regjistruar dhe aty do të përcaktohen kontrollet sipas fashave: kuqe, blu, jeshil!

Më tej drejtoresha e doganave iu përgjigj pyetjeve të sipërmarrëseve.

Gjatë këtij takimi u nënshkrua një marrëveshje midis Dhomës së Tregtisë Tiranë dhe Doganave.



Gruaja dhe shëndeti

Depresioni dhe Lulja e Basanit

Materiale të përpunuara nga **Arlinda Demeti**

Depresioni është një gjendje shpirtërore e çrregullt që shkakton humbjen e energjisë, shtimin e ndjenjës së pikëllimit, nervozizmin dhe humbjen e interesimit për të bërë ndonjë aktivitet ditor. Depresioni ndryshe thuhet se është një çekuelibër kimik dhe mund të vijë nga ndonjë rrethanë e caktuar, gjenetik apo nga një gjendje shëndetësore.

Ka disa lloje depresioni që mund të kenë sipmtoma të ndryshme si: depresion sezonal zakonisht në muajin e vjeshtës dhe të dimrit, depresion i vazhdueshëm dhe i qetë, depresion i dyfishuar si dhe depresion paramenstrual.

Depresioni paramenstrual shfaqet tek gratë që kanë simptoma të ashpra dhe të njejta të çrregullimit fizik apo emocional.

Mund të thuhet se ke rënë në depression nëse ke ndjenjën e shqetësimit dhe mungesën e guximit për të lëvizur, ndjenjën e lodhjes gjatë gjithë kohës, të fjeturit e shumë ose mungesa e gjumit.

Një studim i fundit ka treguar se lulja e basanit mund të ndihmojë në kurimin e formave të lehta dhe të mesme të depresionit. Për më tepër këto kërkime shtojnë se kjo bimë ka efekte anësore më të pakta dhe më të lehta, në krahasim me mjekimet antidepressive. Por gjithashtu lulja

e basanit mund të bashkëveprojë me mjekime të caktuara që merren për të kuruar depresionin. Prandaj duhet që gjithmonë të merret nën mbikqyrjen e mjekut. Kjo lule, e zier në formën e një çaji, mund të përdoret për probleme të lidhura me pagjumësinë, luhatjet e humorit, ankthin dhe depresionin. Kjo bimë ka aftësi në rritjen e prodhimit të së lëndëve kimike që prodhon truri si serotonin, dopamine dhe norepinephrine, të cilat janë përgjegjëse në përmirësimin e humorit.


Vetitë kuruese të lules së basanit, një bimë barishtore që në gjendje natyrale rritet kudo, janë të njohura në mbarë botën. Ajo ka një përdorim të gjerë në mjekësinë popullore apo në produkte të ndryshme medicinale.

Është përdorur prej vitesh, veçanërisht e përzier me vajin e ullirit, si një balsam kurativ dhe rigjenerues. Përdoret në rastet e prerjeve, djegieve dhe plagëve të ndryshme por edhe si një çaj qetësues.

Përzierja e vajit të ullirit me lulen e basanit

Përzierja e vajit të ullirit me lulet e basanit, krijon një masë që në shumë kultura, në mbarë botën konsiderohet si një balsam magjik.

Në vendin tonë ky preparat përgatitet duke ndjekur këtë mënyrë.



Lulet e basanit hidhen në një shishe qelqi me vaj ulliri dhe kjo masë lihet në një ambient të errët për dyzetë ditë.

Pas kësaj kohe, kur farat e lules të kenë lëshuar pigmentin e tyre dhe vaji të ketë marrë ngjyrën e kuqe karakteristike, atëherë kjo përzierje mund të përdoret për të kuruar plagët e diegjet e jashtme.

Mund të konsumohet edhe duke pirë një lugë në ditë për të kuruar sëmundje të ndryshme të stomakut, mëlçisë, e më shumë.

Vaji përdoret edhe për kurimin e formave të ndryshme të gastritit.

Këshillohet që në çdo familje të mbahet një shishe me përzierje vaj ulliri e lule basani. Tani (maj-qershor) është periudha e lulëzimit të lule basanit dhe momenti më i përshtatshëm për të përgatitur balsamin e lule basanit.

Dita e Solidaritetit midis Brezave

Më 3 maj 2018, me rastin e Ditës Europiane të Solidaritetit midis Brezave, në ambjentet e CoDe Albania u mbajt takimi "Dobia social-ekonomike e bashkëpunimit ndërbrezor".

Një takim mjaft interesant i organizuar nga ASAG, ku referuese ishin Mira Pirdeni, Flutura Xhabija etj.



Tryezë e rrumbullakët: "OSHC të afta për t'u adaptuar në kohë ndryshimesh"

Më datë 4 maj 2018, në ambjentet e Hotel Tirana, u mbajt tryeza e rrumbullakët për prezantimin e modeleve të reja biznesi për ekzistencën dhe forcimin e organizatave të shoqërisë civile. Në këtë takim merrnin pjesë ambasadori i SHBA z.Donald Lu, zv/kryeministrja znj.Senida Mesi, të cilët vlerësuan kontributin e dhënë nga shoqëria civile për luftën kundër korrupsionit, trafikëve e drogës, ku gazetarë të guximshëm kanë demaskuar edhe politikanë të përfshirë në këto afëra. Shoqata Partnerët Shqipëri për ndryshim dhe zhvillim prezantuan një studim të kryer nga ana e tyre mbi gatishmërinë e OSHC-ve për përfshirjen në aktivitete që gjenerojnë të ardhura.

Gjithashtu u prezantuan disa eksperiencia të OSHC-ve dhe bizneseve shqiptare në drejtim të shitblerjes së produkteve dhe shërbimeve.

Më tej u prezantuan edhe disa eksperiencia ndërkombëtare në iniciativa të orientuara drejt biznesit për të gjeneruar të ardhura.



Buletin Informativ

Maj 2018

Rr.Mujo Ulqinaku,
Pall.Kristian Konstruktion,
kati 1, ap.9 Tirana-Albania
phone/fax:00355 4 2235726
mob.0682763344, 0692572423
info.shgpaz@yahoo.com



Pergatiti
Msc. Flutura XHABIJA &
Redaksia